

VENDIM
Nr.66, datë 27.7.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDRO ENERGJIA PULITA” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1, germa “a” dhe 15 pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 12, 13, 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Idro Energjia Pulita” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Idro Energjia Pulita” sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes është në proces miratimi.(neni 9 pika 4.1.5).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Idro Energjia Pulita” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Gostivisht” me fuqi 1.3 MW, “Langarica 3” me fuqi 2.2 MW dhe “Ura e Dashit” me fuqi 1.2 MW për një afat 30-vjeçar, me kusht që:

Shoqëria “Idro Energjia Pulita” sh.p.k. të dorëzojë “Miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes” brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licencës.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani